



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	01
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No:	25-5440
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	- 2 -
Data: Datum: Date:	12/07/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit- Ured Ministra -Office of the Minister

Nr: 151/VII/2024

Datë: 12.07.2024

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 11 paragrafi 1.5 i Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca 1 paragrafi 6 nënparagrafi 6.1, nenit 12, paragrafi 1.10 të Ligjit Nr. 04/l-125 për shëndetësi, nenit 1 të Ligjit nr. 02/l-78 për shëndetësi publike, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Nga data 13.07.2024 deri me 20.07.2024 lirohen nga puna gratë shtatzana.
2. Në rast të pamundësisë së lirimit nga puna sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, gratë shtatzana punojnë nga shtëpitë.
3. Nga data 13.07.2024 deri me 20.07.2024 qytetarët me sëmundje kronike punojnë me orar të shkurtuar deri në 4 orë në ditë.
4. Nga data 13.07.2024 deri me 20.07.2024 ndalohet puna në sektorin e ndërtimitarisë në ambiente të hapura gjatë orareve 11:00 - 17:00 në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
5. Varësisht prej temperaturave që mbizotërojnë gjatë muajit korrik dhe gusht - 2024, ndërmerren masat.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Duke u bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës për ndërmarrjen e masave për shkak të temperaturave të larta, që mund të ndikojë në aktivitetet e përditshme dhe të cilat paraqesin rrezik serioz për shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dr. Arben Vitia

Ministër i Shëndetësisë



Vendim i dërgohet:

- *Zyrës së Kryeministrit;*
- *Kabinetit të Ministrit ;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *IKSHPK;*
- *Arkivit të MSh-së.*